



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI BASHKIAK TIRANË**

**V E N D I M**

Nr. 33, datë 09. 10. 2012

**PËR**

**“VENDOSJEN, NË KUADRIN E FESTIMEVE TË 100 VJETORIT TË PAVARËSISË, TË DISA MONUMENTEVE NË SHESHET E QYTETIT TË TIRANËS, “MONUMENTIT TË PAVARËSISË”, “SHTATORES SË ISMAIL QEMALIT”, DHE “SHTATORES SË AHMET ZOGUT””.**

Mbështetur në nenin 8/VII, gërma “a” dhe nenin 32, gërma “m” të ligjit nr.8652, datë 31.07.2000 për “Organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore” (i ndryshuar), pasi mori në shqyrtim relacionin për vendosjen, në kuadrin e festimeve të 100 Vjetorit të Pavarësisë, të disa monumenteve në sheshet e qytetit të Tiranës, konkretisht, “Monumentit të Pavarësisë”, “Shtatores së Ismail Qemalit” dhe “Shtatores së Ahmet Zogut”, me propozim të Kryetarit të Bashkisë së Tiranës, Këshilli Bashkiak,

**V E N D O S I**

1. Të miratojë vendosjen e disa monumenteve në sheshet e qytetit të Tiranës, në vendndodhjet si më poshtë:
  - **“Monumenti i Pavarësisë”**, në parkun Rinia me pamje nga Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, në krah të Ministrisë së Mbrojtjes.
  - **“Shtatorja e Ismail Qemalit”**, në vendpushimin në lulishten e kryqëzimit të Bulevardi “Dëshmorët e Kombit” me rrugën “Ismail Qemali”.
  - **“Shtatorja e Ahmet Zogut”**, në sheshpushimin në fund të Bulevardit “Zogu i I”, pranë Stacionit të Trenit.
2. Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Politikave të Zhvillimit dhe Promovimit të Qytetit për zbatimin e këtij vendimi.
3. Ky vendim hyn në fuqi 10 (dhjetë) ditë pas shpalljes.

**K R Y E T A R I**

**Niazi KOSOVRASTI**